



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 37/4 prot.

Datë 19/01/2023

VENDIM
K.P.P. 44/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.01.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr. 37 prot, datë 11.01.2023 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-52898-12-12-2022, me objekt: “Evadimi I mbetjeve urbane në S. U. “Shefqet Ndroqi”, Tiranë – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik – ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 2 vite (24 muaj)” me fond limit 9,907,560 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 28.12.2022 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Silver” SHPK
Adresa: Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Bajram Curri”,
Pallatet 1 Maji, Godina 7, Shk.4, Kati 1, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë.
Adresa: Rruga “Shefqet Ndroqi” Sauk, Tiranë.

Baza Ligjore: Nennet 30 dhe 117 të Ligji nr. 162/2022 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.12.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-52898-12-12-2022, me objekt: “Evadimi I mbetjeve urbane në S. U. “Shefqet Ndroqi”, Tiranë – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik – ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 2 vite (24 muaj)” me fond limit 9,907,560 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 28.12.2022 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë.

II.2. Në datën 11.01.2023 operatori ekonomik “Silver” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorët e tjerë ekonomikë të kualifikuar në procedurën e prokurimit. Konkretisht, operatorët ekonomikë “Alpen Pulito” SHPK, “Korsel” SHPK, “V.A.L.E. Recycling” SHPK, “Pastrime Silvio” SHPK. Bazuar në nenin 112, pika 4 të ligjit

nr. 162/2022 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi në datën 12.01.2023 “Formularin për Publikim” nr. 37/2, duke pasqyruar arsyet që pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë “Alpen Pulito” SHPK, “Korsel” SHPK, “V.A.L.E. Recycling” SHPK dhe “Pastrime Silvio” SHPK pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 19.01.2023 operatori ekonomik ankimues “Silver” SHPK me anë të shkresës protokolluar me tonën me nr. 37/3 prot., datë 19.01.2022, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-52898-12-12-2022, me objekt: “Evadimi I mbetjeve urbane në S. U. “Shefqet Ndroqi”, Tiranë – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik – ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 2 vite (24 muaj)” me fond limit 9,907,560 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 28.12.2022 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik “Silver” SHPK, për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-52898-12-12-2022, me objekt: “Evadimi I mbetjeve urbane në S. U. “Shefqet Ndroqi”, Tiranë – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik – ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 2 vite (24 muaj)” me fond limit 9,907,560 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 28.12.2022 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”.

III.1.2. Bazuar në parashikimet e nësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqjen dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës nr. 37 prot, datë 11.01.2023 për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative. Për sa më sipër, në

mbështetje të neneve 30, dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-52898-12-12-2022, me objekt: “Evadimi I mbetjeve urbane në S. U. “Shefqet Ndroqi”, Tiranë – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik – ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 2 vite (24 muaj)” me fond limit 9,907,560 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 28.12.2022 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Silver” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri